Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 145/22
Datë/Datum. 20.05.2022
PRISHTINË - PRIŠTINA

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Visar Kastrati	18.05.2022	20.05.2022	145/22
Emri dhe Mbiemri i ekspertit shqyrtues dhe nënshkrimi	*Data e autorizimit të ekspertit*	*Data e dorëzimit të raportit*	*Nr. i lëndës*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 13.05.2022, OE "N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I)" - Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr.: 145/22, kundër njoftimit mbi vendimin e AK-së të aktivitetit të prokurimit: "Zhvillimi mirëmbajtja e Sistemit të kontrollimit të ushqimit dhe menaxhimit të gjurmueshmërisë" me nr. të prokurimit: 40800-21-5243-2-1-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: shërbime, vlera e parashikuar e kontratës: 418,000.00€.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Dispozitat e shkelura

Konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka proceduar në kundërshtim me:

Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

- Neni 1 – paragrafi 1
- Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,6
- Neni 59 – paragrafi 4

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Neni 1 – paragrafi 1 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 1 - Qëllimi

1. Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT, zyra e prokurimit, komisioni i vlerësimit nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 1.

Ne si OE NTSH UNISOFT kemi aplikuar në projektin në fjalë dhe jemi të përgjegjshëm, AK ka kryer shkelje duke mos i përmbushur dhe respektuar detyrimet si autoritet kontraktues sipas nenit 1 të LPP.

Neni 7 – paragrafi 1,2,3,4,5,6,7 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

Ne konstatojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT ofertën tone nuk e ka trajtuar ne baze te ligjeve te LPP, ka anuluar aktivitetin e prokurimit dhe me vendimin për anulim ne si OE NTSH UNISOFT jemi diskriminuar dhe nuk jemi trajtuar sipas LPP.

Ne si OE jemi oferte e përgjegjshme dhe i plotësojmë te gjitha kërkesat ne dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontrate. Andaj ne si OE jemi diskriminuar përkundër qe ne i plotësojmë te gjitha kërkesat administrative. Kjo dëshmohet me dokumentacionet dhe certifikatat te cilat ne kemi dërguar ne dosjen e tenderit.

Ne si OE i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat lidhur me referencat. Ne kemi dorëzuar Referenca të cilat janë të protokolluara dhe të nënshkruara nga institucione të Republikës së Kosovës (Referenca 1227 dt. 17.05.2019, Referenca 90400/16/01/015/215 dt. 13.06.2016 , Referenca 03.117 dt. 20.05.2019 , Referenca 3/208)

Neni 59 – paragrafi 1,4 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

3. Autoriteti kontraktues do të themeloi një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës. Me fillimin e zbatimit të prokurimit elektronik, KRPP-ja do ta nxjerrë legjislacion dytësor lidhur me këtë çështje.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 59.
Dhe se ne si OE NTSH UNISOFT jemi ofertë e përgjegjshme dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. Andaj ne si OE pretendojmë që AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT nuk ka kryer ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë. AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT dhe komisioni vlerësues janë përgjegjës individualisht për neglizhencën dhe zvarritjen e procesit të vlerësimit.
Referenca të cilat janë të protokolluara dhe të nënshkruara nga institucione të Republikës së Kosovës (Referenca 1227 dt. 17.05.2019, Referenca 90400/16/01/015/215 dt. 13.06.2016 , Referenca 03.117 dt. 20.05.2019 , Referenca 3/208)

3	Avancimi dhe mirëmbajtja e softuerit për digjitalizimin e shërbimeve akademike dhe administrative në kuadër të projektit Tempus (SD@UHz)	15.09.2016 15.09.2019	109,430.00 €	Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Kosovë
2	Mirëmbajtja e Sistemit Elektornik të Menaxhimit të Punëve me Studentë në Universitetin e Prishtinës	13.06.2016 12.06.2019	204,768.00 €	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" – Prishtinë, Kosovë
4	SMU – Sistemi i Menaxhimit Universitar	15.05.2018 14.05.2021	99,000.00 €	Universiteti "Ukshin Hoti" – Prizren, Kosovë
7	Zhvillimi i moduleve shtesë për avancimin e shërbimeve në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina	20.05.2018 20.05.2019	91,155.00 €	Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" – Prishtinë, Kosovë

AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT në dosje ka pasur vlerat e kontratës, referencat, kohen e realizimit të tyre. Dhe mbi të gjitha AK duhet të shërbehet me informacionet e dorëzuara dhe verifikimin e tyre mbi saktësinë apo jo. Ne kemi dorëzuar projekte të cilat kemi bashkangjitur referencat sipas kërkesave nga AK. Të njëjtat ka mundur ti verifikoj apo sqaroj sipas Nenit 72 apo Nenit 59.3
Menaxheri i projektit i ofruar nga ne NTSH UNISOFT, i plotëson të gjitha kriteret lidhur me përvojën dhe kualifikimet tjera të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit, dhe AK ka mundur ti sqaroj sipas LPP dhe RROUP Nenit 72 apo Nenit 59.3.
Zhvillues të softuerit të ofruar nga ne NTSH UNISOFT i plotësojnë të gjitha kriteret lidhur me përvojën dhe kualifikimet tjera të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit, dhe AK ka mundur ti sqaroj sipas LPP dhe RROUP Nenit 72 apo Nenit 59.3.

Eksperti për data baze të ofruar nga ne NTSH UNISOFT i plotësojnë të gjitha kriteret lidhur me përvojën dhe kualifikimet tjera të cilat janë kërkuar në dosjen e tenderit, dhe AK ka mundur ti sqaroj sipas LPP dhe RROUP Nenit 72 apo Nenit 59.3.

Neni 62 – paragrafi 1,2 - Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092
Neni 62 - Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit
1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
1.1 një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njërën nga arsyet:
2.1 të gjithë tenderët e përgjegjshëm përmbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo
2.2 para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Ne pretendojmë që kjo dispozitë e LPP është shkelur pasi AK – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT nuk ka trajtuar në parim RROUP dhe LPP duke përfshi nenin 62.
Arsye e anulimit të aktiviteti të prokurimit është në kundërshtim me këtë dispozitë pasi nuk plotësohen konditat dhe kushtet që një aktivitet i prokurimit të anulohet sipas LPP-së neni 62. Vendimi mbi anulimin i datës 26.04.2022 është në kundërshtim me dispozitën ligjore të LPP dhe RROUP.
Kërkojm nga AK – AUV që të nxjerr:

VENDIM

I. APROVOHET, si e bazuar Kërkesa për Rishqyrtim
II. ANULOHET Vendimi i datës 26.04.2022 i AK – AUV dhe lënda të kthehet në Rivlerësim

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat

Kërkesa 1:
Kontrate te realizuara me shërbime te ngjashme SQL Server, Platforma .NET Core, React.JS, Framesolution në 3 vitet e fundit (nënkupton periudhën kohore që paraprinë datën e publikimit te njoftimit për kontrate). Vlera totale e shërbimeve te realizuara duhet te jetë min. 200,000.00 Euro.

Kërkesa 2:
Stafi që do të jetë i përfshirë në këtë projekt
a). Një (1) Menaxher Projekti - Të ketë përvojë pune të paktën 5 vite per menaxhim te projekteve te ndryshme të nivelit të këtij projekti si platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve

teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore. - Të jetë i e diplomuar në Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike ose Sisteme te Informacionit - Të jetë i çertifikuar në Project Management Professional (PMP)- për menaxhim të projekteve apo të ngjashme.
b). Një (1) Zhvillues Softueri- Senior - Të ketë përvojë pune të paktën 5 vite në te paken 1 projekti të nivelit të këtij projekti si platforma platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore. - Të ketë përvojë punë ne teknologjitë si SQL Server 2016, Platforma .NET Core, React.JS, Framesolution. - Të jetë i e diplomuar në per Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike ose Informatike.
c). Një (1) Ekspert për Data Bazë - Të ketë përvojë pune 2 vite në projekte të nivelit të këtij projekti - Përvojë pune në zhvillimin e data bazave në të paktën 2 projekte që janë të ndërtuara në teknologji të Microsoft ose ekuivalente për ueb aplikacione. - Të jetë i e diplomuar në per Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike ose Informatike.
d). Min. tre (3) Zhvillues Softueri për zhvillimin e aplikacioneve softuerike - Të ketë përvojë pune të paktën 2 vite në projekte të nivelit të këtij projekti - Të kenë përvojë pune në zhvillimin e ueb aplikacioneve, në të paktën 2 projekte që janë të ndërtuara në teknologji të Microsoft ose ekuivalente për ueb aplikacione. - Të jene te diplomuar në per Shkenca Kompjuterike ose Inxhinieri Kompjuterike ose Informatike.

Dëshmia Dokumentare

Dëshmia 1:
Referencë pozitive për kontratat e realizuara, në referenca duhet të jetë e cekur vlera e realizuar e shërbimeve, për kontratat me Operator privat janë të pranueshme përveç referencës kur të njëjtat dëshmohen me transaksione bankare apo me fatura tatimore.

Dëshmia 2:
Lista e stafit qe do të jetë i përfshire në këtë projekt (e vulosur dhe nenshkuar nga OE)
a). Menaxheri i projektit - Te deshmohet me CV, përfshi kontaktet për verifikim dhe me referencë nga punedhenesi klienti. - Të dëshmohet me diplome nga Universiteti - Të dëshmohet me certifikate perkatese nga organizate e njohur nderkombetarisht
b). Zhvillues Softueri- Senior - Te deshmohet me CV, përfshi kontaktet për verifikim dhe me referencë nga punedhenesi klienti. - të dëshmohet me diplome nga Universiteti
c). Ekspert për Data Bazë - Te deshmohet me CV, përfshi kontaktet për verifikim dhe me referencë nga punedhenesi klienti. - Të dëshmohet me diplome nga Universiteti - Të dëshmohet me certifikate a perkatese nga Microsoft ose organizate e njohur nderkombetarisht.
d). Zhvillues Softueri - Te deshmohet me CV, përfshi kontaktet për verifikim. - Të dëshmohet me diplome nga Universiteti

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni konstaton qe ky tender duhet te anulohet sepse asnjeri nga ofertuesit nuk i plotesojne kerkesat e cekura ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin per kontrate keshtu qe arsyet jane te cekura me poshte:

a) Grupi i OE Prodif ShPK dhe Infinik Engineering ShPK; Kerkesa 1. Ne referencen e leshuar nga MAShT me date: 05.11.2020 nuk e arrin vleren e kerkuar sepse vlera e references eshte 180,520.00 €. Kerkesa 2. 1. Menaxheri i projektit nuk ka reference nga punedhenesi klienti siç kerkohet ne dosjen e tenderit e cila mund te deshmoje pervojen ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte e cekur ne dosjen e tenderit. 2. Zhvilluesit te softuerit - Senior i mungon pervoja 5 vjeçare ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte cekur ne dosjen e tenderit, gje qe nuk mund ta deshmojne as me referenca nga punedhenesi klienti. Gjithashtu diploma e Universitetit Shteteror te Tetoves eshte e pa nostrifikuar. 3. Ekspertit per data baze i mungon referenca nga punedhenesi klienti sikur qe eshte cekur ne dosjen e tenderit.

b) Operatori ekonomik Novus ShPK 1. Menaxheri i projektit nuk ka reference nga punedhenesi klienti siç kerkohet ne dosjen e tenderit e cila mund te deshmoje pervojen ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte e cekur ne dosjen e tenderit. 2. Ekspertit per data baze i mungon referenca nga punedhenesi klienti siç eshte e cekur ne dosjen e tenderit.

c) Grupi i OE Tech Vision ShPK dhe Edusoft d.o.o Shkup, 1. Menaxheri i projektit i mungon pervoja 5 vjeçare ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte e cekur ne dosjen e tenderit, gje qe nuk mund ta deshmojne as me referenca nga punedhenesi klienti. 2. Leter referenca me numer 07, e dates 31.01.2017, e Ieshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarise se Republikes se Maqedonise se Veriut dhe e nenshkruar nga shefi shendetit dhe mireqenies se kafsheve, nuk eshte dokument autentik sepse pas marrjes se informacioneve nga ky i fundit leter reference ka leshuar nga institucioni i Agjencise se Ushqimit dhe Veterinarise ne vitin 2014. Pra kjo leter reference eshte e dyshimte. 3.Zhvilluesit te softuerit-Senior i mungon pervoja 5 vjeçare ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte cekur ne dosjen e tenderit, gje qe nuk mund ta deshmojne as me referenca nga punedhenesi klienti. 4. Ekspertit per data baze i mungon referenca nga punedhenesi klienti sikur qe eshte cekur ne dosjen e tenderit.

d) Grupit te operatoreve ekonomik Pan Live Stock Service Limited dhe Lioni ShPK - i mungon deklarata nen betim kompanise Loni Shpk e cila eshte pjese e konsorciumit keshtu qe ky eshte nje kusht administrativ dhe si komision vleresues nuk kemi vazhduar me vleresimin e kesaj oferte.

e) Arianit R. Bytyqi-Uni Soft -Mungojne referencat e kerkuara ne dosjen e tenderit per kompani, edhe pse i ka paraqite referencat me numër portokoli 1227 te dates 17.05.2019 ne reference nuk eshte e cekur shuma e kontrates siç kerkohet ne dosjen e tenderit. Referenca me numër 90400/16/01/015/215 te dates 13.06.2016 nuk ka shumen e kontrates. -Referenca e me numer

03-117 e dates 20.05.2019 nuke ka te cekur shumen e kontrates. -Referenca me numer 3/208 nuke ka te cekur shumen e kontrates. -Menaxherit te projektit i mungon pervoja 5 vjeçare ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore sic; eshte e cekur ne DT, gje qe nuk mund ta deshmojne as me referenca nga punedhenesi klienti. Zhvilluesit te softuerit -Senior i mungon pervoja 5 vjeçare ne platforma per avancimin, funksionalizimin e sistemeve teknologjike te informacionit per qasje te integruar ne sigurine ushqimore siç eshte cekur ne DT, gje qe nuk mund ta deshmojne as me referenca nga punedhenesi klienti. Eksperti per data baze nuk ka referenca siç kerkohet ne DT.

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

N/A

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

N/A

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES OE "N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I)" - Prishtinë

Pretendimet ankimore të OE ankues kanë të bëjnë me ankesën e dërguar në OSHP me datë 13.05.2022.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 1

Pretendimi ankimor ka të bëjë me atë se: OE ankues plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit në raport me referencat e dorëzuara.

Lidhur me ketë pretendim ankimor OE ankues në platformën e E-Prokurim-it në dokumentin *"13_UNISOFT_Referenca"* ka paraqitur referencat në të cilat nuk figuron shuma e kontratës, siç kërkohet në dosjen e tenderit. Mirëpo, në dokumentin tjetër i cili është paraqitur në sistemin e E-Prokurimit *"12_UNISOFT_ListaKontrataReferenca"*, ekziston lista e këtyre referencave/kontratave, ku

përmban shumën e kontratës.

Prandaj, në mënyrë që të qartësohet dhe mundësohet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve sa më i saktë, në bazë të Nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikës 39 të RRUOPP-së, AK mund të bëjë *"Kërkesë për sqarim të tenderit"* në bazë të pikës 39 të RRUOPP-së, pasi kemi të bëjmë me Aftësinë Teknike dhe/ose Profesionale të përcaktuara në Nenin 69 të LPP-së, ndërsa shprehimisht tek pika 39 e RRUOPP-së thuhet se: *"Mungon referenca/certifikata e pranimit nga lista e kontratave te prezantuara - Mund te kërkohen informata sqaruese"*. Prandaj, bazuar në sqarimet e mësipërme, ***pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar***.

Përgjigje në pretendimin ankimor nr. 2

Pretendimi ankimor ka të bëjë me atë se: OE ankues i plotëson të gjitha kriteret siç kërkohet në dosjen e tenderit lidhur me Menaxherin e projektit, Zhvilluesit të Softuerit dhe Ekspertit për databazë.

OE ankues në platformën e E-Prokurimit ka paraqitur stafin dhe dokumentet të cilat janë shtjelluar si në vijim:

a) Menaxher i Projektit – Në platformën e E-Prokurimit në dokumentin e ngarkuar *"16_UNISOFT_ListaStafitReferencatPunedhenesit"*, Fisnik Meha është paraqitur se do të angazhohet si Menaxher i Projektit. Në të njëjtin dokument është paraqitur se përvoja e tij është 14 vite. Po ashtu, në folderin *"17_UNISOFT_MenaxherProjektit"*, është paraqitur CV e cila nuk përmban numrin e viteve të përvojës së punës, por ka shkollimin, eksperiencën dhe projektet në të cilat ka qenë i angazhuar.
b) Zhvillues Softueri (Senior) - Në platformën e E-Prokurimit në dokumentin e ngarkuar *"16_UNISOFT_ListaStafitReferencatPunedhenesit"*, Kujtim Mustafa është paraqitur se do të angazhohet si Zhvillues softueri - Senior. Në të njëjtin dokument është paraqitur se përvoja e tij është 6 vite. Po ashtu, në folderin *"18_UNISOFT_Zhvillues i softuerit Seniro"*, është paraqitur CV e cila përmban periudhën e përvojës së punës për secilin projekt në të cilin ka qenë i angazhuar.
c) Ekspert për Databazë - Në platformën e E-Prokurimit në dokumentin e ngarkuar

"16_UNISOFT_ListaStafitReferencatPunedhenesit", Adrian Krasniqi është paraqitur se do të angazhohet si Ekspert për Data Bazë. Në të njëjtin dokument është paraqitur se përvoja e tij është 6 vite. Po ashtu, në folderin *"19_UNISOFT_Zhvillues i Bazes se te dhenave"*, është paraqitur CV e cila përmban periudhën e përvojës së punës për secilin projekt në të cilin ka qenë i angazhuar dhe shkathtësitë e tjera teknike.

Bazuar në të dhënat e mësipërme, lidhur me përvojën e punës për stafin, konsiderojmë si të paqartë vlerësimin nga AK për mungesë të përvojës. Në mënyrë që të jetë një vlerësim i saktë duhen shtjelluar secilin projekt që ka paraqitur stafi i sipërpërmendur në CV-të e tyre. Për më tepër, duhet të saktësohet qartë mungesa eventuale e përvojës, krahasuar me platformat në të cilat është kërkuar përvoja në dosjen e tenderit.

Prandaj, në mënyrë që të qartësohet dhe mundësohet ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve sa më i saktë, në bazë të Nenit 59 dhe 72 të LPP-së dhe pikës 39 të RRUOPP-së, AK mund të bëjë *"Kërkesë për sqarim të tenderit"* në bazë të pikës 39 të RRUOPP-së, në rastin kur *"CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund te vendos"*. Prandaj bazuar në sqarimet e mësipërme, ***pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar***.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues ***të aprovohet si pjesërisht e bazuar***, rekomandon që të anulohet njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në ***rivlerësim***.

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – AGJENCIONI VETERINARISË DHE USHQIMIT
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – OE "N.T.SH. "UNISOFT" (Arianit R. Bytyqi B.I)" - Prishtinë